



DEPARTMENT OF COMMUNICATIONS
OFFICE OF PUBLIC RELATIONS
305 Michigan Avenue
Detroit, Michigan 48226
www.AODcommunications.org
TEL 313-237-5943
FAX 313-237-4644

13 Mars, 2010

Nga Peshkopata e Detroit, ne reference te verejtjes se Ate Anton Kcira, Komuniteti Shqiptar, dhe marredhenies ndermjet Kristianeve Katolik dhe Myslimaneve

Nga shqetesimi i thelle mbi konfliktin dhe ngaterrimin krijuar ne komunitetet Katolik dhe Mysliman nga verejtjet e dhena nga Ate Fran Kcira i Famullit Shqiptar Shen Paul ne Rochester Hills, Michigan, Arkipeshkop Allen H. Vigneron ka kerkuar qe prifti te japi nje deklarate me shkrim. Arkipeshkopi ka renen dakort te ndihmoje ne shperndarjen e deklarates se Ate Kcires ne vend te tij.

Nje letter e hapur nga Ate. Anton Kcira per Komunitetin Shqiptar dhe pertej:

Ne pak javet e fundit, ka qene nje paqartesi shume e madh mbi permbajtjen e nje kasete vidio qe kam shperndare ne famullin tim ne Maj te 2007. Ndersa shumica e tyre jane shperndare neper internet dhe ne media, une doja te merrja mundesine te hidhja ne leter ndjenjat e mia ne lidhje me kete ceshtje.

Ne kohen qe une kam mbajtur fjalimin para tre vjeteve une isha i nevrikosur...shume i nevrikosur me mungesen e pergjigjes ne komunitetet Shqiptar dhe Kosovar kundrejt krimineleve te cilet planifikuan te vrasin ushtaret Amerikane ne Fort Dix, New Jersey. Shtetet e Bashkuara te Amerikes dhe NATO kan bere shume per ne nder vite....dhe duke mos denuar kriminelet shqiptar ne dukemi mosmirenjohes.

Duke shprehur zemerimin tim, une perdora ate qe nje mesues anglishteje do ta quante hiperbole...nje ekzaxhirim i perdorur per efekt...per ta bere shume te qarte. Duke bere kete une perdora disa fjale te gabuara...perdora shembuj te keqij...pershkrova viktima masakre me emra provokues. Kjo nuk ishte e drejte. Me vjen thellesisht shume keq per ato fjale qe kam perdorur dhe per dhimbjet qe fjalet e mia kane shkaktuar. Ai ishte nervozizmi im qe fliste, jo zemra ime.

Ne Kosove dhe ketu ne Detroit, une kam qene mirenjohes dhe krenar i pjesemarrjes time ne perpjektjet bashkepunuese ndermjet shqiptareve te te gjitha feve. Ne ndajme dashurine e perbashket per vendin tone...pamvaresine tone. Une i respektoj njerezit e fese myslimane, dhe e shikoj marredhenien ndermjet Kristianeve dhe Myslimaneve si nje mardhenie te bazuar ne aktivitetet zakonshem per paqe dhe dashamiresi. Une lutem qe ajo cfare une kam thene te mos lendoje ne asnje

-- MORE --

menyre, mardhenien tone me vlere ndermjet dy feve. Dhe, une besoj se shperthim nervozizmit per te cilin jam penduar nuk do te pakesoj projektet te cilat komunitetet tona besimatere kane mbeshtetur dhe kane punuar se bashku nder vite, ose te shkaterroje ecjen perpara te marredhenieve tona.

Zoti na bekoftë te gjithëve,

Rev. Anton Kçira
Kisha Katolike Romane Shqiptare Shen Paul
Rochester Hills, Michigan

###